



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:083374
Datë: 19.03.2024
Numri i dokumentit: 05472676

C.A.P.nr.1808/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, nga Gjykatësi Individual Besnik Feka, në çështjen juridike-përmbartimore të kreditorit Komuna e Mitrovicës, kundër debitorit S.F. I. me adresë në rrugën “Dëshmorët e Kombit”, Komuna e Mitrovicës, për realizimin e detyrimeve tatimore të papaguara, në lartësi të borxhit prej 2,482.99 euro, në bazë të Vendimit Administrativ të datës 17.10.2022, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditores të ushtruar përmes të autorizuarit të saj avokat Lirim Zeka nga Prishtina, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë –Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.109/23, i datës 25.08.2023, me datë **19.03.2024**, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET SI E BAZUAR ankesa e kreditores Komuna e Mitrovicës, ushtruar përmes të autorizuarit të saj, avokat Lirim Zeka nga Prishtina, ashtu që, **NDRYSHOHET** Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm me numër PPP.nr.109/2023, i datës 25.08.2023, dhe **REFUZOHET SI I PA BAZUAR** prapësimi i debitorit S. I. nga Mitrovica, ndërsa Urdhri për Lejimin e Përmbartimit të Përmbartuesit Privat me numër P.nr.1705/2022, dt:22.12.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë –Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me aktvendimin, PPP.nr.109/2023, i datës 25.08.2023, ka vendosur si në vijim:

- I. **APROVOHET** prapësimi i debitorit S F I nga Komunën e Mitrovicës, ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përmbartimin P.nr.1705/22 të datës 22.12.2022, dhe;

II. **SHFUQIZOHET** urdhri mbi lejimin e përmbarimin P.nr.1705/22 të datës 22.12.2022, dhe të gjitha veprimet e ndërmarra përmbarimore abrogohen.

Kundër këtij aktvendimi në afatin e përcaktuar ligjor ankesë ka ushtruar kreditori Komuna e Mitrovicës, përmes përfaqësuesit të saj me autorizim, L.Z. avokat nga Prishtina, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave procedurale si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke e kundërshtuar në tërësi aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, me propozim që gjykata e shkallës së dytë aktvendimin e atakuar ta ndryshoj dhe refuzoj prapësimin e debitorit, ndërsa Urdhërin për Lejimin e Përmbarimit ta vërtetoj.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur debitori.

Gjykatësi Individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194, 201, pika b) në lidhje me nenin 208, 209 pika c) dhe 210 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e kreditores Komuna e Mitrovicës, ushtruar përmes të autorizuarit të saj, avokat Lirim Zeka nga Prishtina, rezulton e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori Komuna e Mitrovicës, me datën 22.12.2022, pranë organit përmbarues-përmbaruesit privat ka ushtruar propozim për ekzekutim në bazë të dokumentit përmbarimor-vendimit të kreditorit për ekzekutimin e detyrimeve tatimore ta pa paguara në shumë prej 2,482.99 euro.

Organi përmbarues me Urdhërin për Lejimin e Përmbarimit P.nr.1705/22, i datës 22.12.2022 e ka lejuar përmbarimin sipas propozimit të kreditorit.

Brenda afatit të përcaktuar ligjor pas pranimit të Urdhrit për Lejimin e Përmbarimit, debitori S. I. nga M., ka ushtruar prapësim, duke e kundërshtuar urdhrin për lejimin e përmbarimit, duke pretenduar se detyrimi i tatimit të pa paguar nga debitori është i parashkruar konform nenit 352 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, dhe mbi bazën e të gjitha këtyre dhe arsyeve tjera, gjykatës i ka propozuar që të aprovoj prapësimin e debitorit-trashëgimtarit të tij ligjor si të bazuar dhe shfuqizoj urdhrin për lejimin e përmbarimit.

Kreditori, brenda afatit ligjor ka ushtruar përgjigje në prapësimin e debitorit, duke i kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit, me propozim që gjykata të refuzoj si të pa bazuar prapësimin e debitorit dhe të vërtetoj udhrin për lejimin e përmbarimit.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të prapësimit të debitorit, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, me aktvendimin, e ankimuar e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se gjykata pas shikimit të shkresave të lëndës konkretisht dokumentit përmbarimor që i ka shërbyer kreditorit si bazë për iniciimin e procedurës përmbarimore, gjegjësisht se ai plotëson kushtet që i njëjti dokument të shërbej si bazë për lejimin e përmbarimit, konform dispozitave të LPP-së, më

saktësisht konform neneve 21, 22 paragrafi 1.2 e në lidhje me nenin 36 paragrafi 1 i cili parasheh se “*Së bashku me propozimin për përmbardim, organit përmbardues i dorëzohet edhe dokumenti përmbardues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbardueshmërisë për përmbardueshmëri*”, lejimi i përmbardimit pa u plotësuar këto prezumime procedurale, përbën shkelje të dispozitave të procedurës përmbardimore, andaj duke ju referuar dispozitës së lartcekur, e gjithashtu edhe duke u bazuar edhe në praktikën gjyqësore, gjykata është e obliguar zyrtarisht të vlerësoj nëse janë përmbushur prezumimet lidhur me propozimin për përmbardim dhe dokumentin përmbardimor.

Andaj, Gjykata ka vlerësuar dokumentin përmbardimorë (Vendimit Administrativ të datës 17.10.2022), ku më dispozitat e LPP-së, në mënyrë të qartë është paraparë se organi përmbardues e lejon përmbardimin në bazë të dokumentit përmbardues (*titulus executionis*), i cili dokument e ka klauzolën e përmbardueshmërisë për përmbardueshmëri, e lidhur me nenin 38 paragrafi 1 të LPP-së i cili nen parasheh se “*Propozimi për përmbardim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbardim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbardimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbardimi, kërkuesi i përmbardimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorëve, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbardimi, objekti i përmbardimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbardimit*”, e në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet që të lejohet përmbardimi pasi që nga shkresat e lëndës vërtetohet se përmbarduesi privat propozimin për përmbardim e ka lejuar pa u plotësuar kushtet ligjore ashtu siç parashihen në nenin 36 paragrafi 1 dhe 38 paragrafi 1 të LPP-së, gjegjësisht vendimi qe ka shërbyer si bazë për lejimin e përmbardimit nuk ka klauzolë të përmbardueshmërisë.

Pasi që në rastin e lejimit të përmbardimit janë bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës përmbardimore, gjykata e shfuqizoj urdhrin mbi lejimin e përmbardimit dhe fare nuk u lëshua në vlerësimin e provave në mënyrë qe të vërtetohet gjendja faktike në këtë çështje përmbardimore. Andaj, nga arsyet e cekura më lartë, konform dispozitave të nenit 3, 9, 36 paragrafi 1, 22, 38 paragrafi 1, 69, 71 e 73 paragrafi 3 të LPP-së, andaj mbi këtë bazë gjykata vendosi si në diapozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë duke i vlerësuar pretendimet ankimore të përfaqësuesit të kreditorit, konsideron se të njëjtat janë të bazuara për faktin se gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar gabimisht shkresat e lëndës, gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike në rastin konkret kur ka nxjerr përfundimin se vendimi për ekzekutimin e detyrimeve tatimore të pa paguara i kreditorit Komuna e Mitrovicës nuk e përmban klauzolën e përmbardueshmërisë dhe se bazuar në nenin 36 par.1 të Ligjit për Procedurë Përmbardimore nuk janë plotësuar kushtet ligjore për lejimin e përmbardimit, ngase me nenin 24 par.3 i Ligjit për Procedurën Përmbardimore përcakton se: “**Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbardimor, po që se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë**”, ndërsa neni 144 i Ligjit për Procedurën Administrative paragrafi 1, nënpar.1.4 përcakton se: “**Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.4 njoftimin e palës me aktin e ndalimit të efektit pezullues të ankesës, në pajtim me paragrafin 3 të nenit 130 të këtij Ligji**”, e gjithashtu mbi bazën e nenit 24 par.5 të LPP-së, ku përcaktohet se “*Përmbardimi caktohet në bazë të*

vendimit gjyqësor që ende nuk është bërë i formës së prerë, ose në bazë të vendimit të dhënë në procedurën administrative që nuk është bërë përfundimtar, vetëm po qe se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet tjera juridike, nuk e ndalojnë përmbartimin”, e ndërlidhur me nenin 31 par.3 të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr. 06/L-005, ku përcaktohet se ankesa ndaj faturës së tatimit në pronë nuk e pezullon detyrimin për pagesën e detyrimeve tatimore, e gjithashtu mbi bazën e nenit 22 par.1, nënpar.1.2 të Ligjit për Procedurë Përmbartimore si dokument përmbartimor konsiderohet edhe “Vendimi i dhënë në procedurë administrative dhe akt pajtimi-ujdia e lidhur në procedurë administrative”, ndërsa me nenin 22 par.1, nënpar.1.1 të këtij ligji përcaktohet se përveç titujve përmbartimor të përcaktuar në nenin 22 par.1, nënpar.1.1 deri në nënpar 1.8 si titull përmbartimor konsiderohet edhe “dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument përmbartues”, e në rastin konkret me nenin 30 par.5 të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.06/L-005 sa i përket vendimit të lëshuar nga komunat për inkasimin e detyrimeve tatimore të pa paguara nga subjektet fizike dhe juridike përcakton se “Vendimi për ekzekutimin e detyrimeve tatimore të papaguara përbën titull ekzekutiv dhe përfshin informacionet e mëposhtme: 5.1. informacionin e nevojshëm për të identifikuar debitorin; 5.2. shumën totale të tatimit të papaguar për çdo vit tatimor të mëparshëm; 5.3. shumën totale të gjobës/gjobave të papaguara për çdo vit tatimor të mëparshëm; 5.4. shumën totale të interesit të llogaritur deri në datën e marrjes së vendimit sipas këtij Ligji për çdo vit tatimor të mëparshëm; 5.5. kompetencën e Komunës apo Ministrisë së Financave për të marrë një vendim të tillë; dhe 5.6. njoftimin mbi aplikimin e interesit deri në datën e pagesës së plotë të tatimit të papaguar”, prandaj, në rastin konkret, duke shikuar përmbajtjen e vendimit për tatimin në pronë dhe shkresat e lëndës, konstatohet se debitori konform nenit 35 par.4 të Ligjit për Procedurë Përmbartimore nr. 04/L-139, nuk kanë ushtruar ndonjëherë ankesa ndaj faturës së tatimit në pronë apo çertifikatës së pronës për vlerësimin e pranuar nga kreditori në emër të pronës së tij, prandaj, në rastin konkret, vendimi për ekzekutim të detyrimeve tatimore të pa paguara të kreditori përbën dokument përmbartimor në momentin e nxjerrjes së tij dhe pavarësisht faktit që nuk posedon klauzolë të përmbartueshmërisë, ligji përkatës për tatimin në pronën e paluajtshme neni 30 par.5 i jep fuqi ekzekutuese të menjëhershme me përmbushjen kumulative të kushteve në paragrafët pasues të cilat kushte në rastin konkret janë përmbushë në tërësi, andaj, edhe gjykata e shkallës së parë, me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike në rastin konkret.

Gjykata e Apelit, në rastin konkret, vërteton se gjykata e shkallës së parë kur ka vendos për prapësimin, gabimisht ka vendosur kur ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe gjykata e shkallës së dytë duke vlerësuar edhe pretendimet e ushtruara në prapësim debitorit se kërkesat e kreditorit në raport me debitorin sa i përket detyrimeve tatimore të pa paguara janë të parashkruara bazuar në nenin 352 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077, gjeti se të njëjtat pretendime janë të pa bazuara, për faktin se nisur nga kartela financiare e kreditorit, shihet se detyrimet tatimore të pa paguara për borxhin e akumuluar të debitorit datojnë që nga 2017 e gjer në fund vitin 2022, dhe se me nenin 352 par.1, të LMD-së, përcaktohen afatet e parashkrimit 5 vjeçar si afat i përgjithshëm i parashkrimit, mirëpo, jo edhe detyrimet tatimore që inkasohen nga komunat si e drejtë që buron nga neni 26 par.1 të Ligjit mbi Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr. 06/L-005, dhe se në rastin konkret përderisa nuk ka afat të veçantë të rrjedhjes së parashkrimit as në Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077, dhe as në Ligjin për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr. 06/L-005 (me përjashtim të Ligjit për Plotësim-Ndryshim të Ligjit për Tatim në Pronë nr. 08/L-224, nenit 8 përcaktohet që pas nenit 30 të shtohet par 30/A ku parashihet afati 10 vjeçar i parashkrimit të kërkesave tatimore e që në rastin konkret nuk aplikohet, por edhe me aplikimin e të njëjtit nuk ka kalim të afatit të parashkrimit në rastin konkret), për kërkesat e këtij lloji të detyrimit tatimor, atëherë aplikohet afati 5 vjeçar si afat i përgjithshëm i rrjedhjes së parashkrimit sipas nenit 352 të LMD-së, dhe duke iu referuar kësaj

rrjedh se përderisa konstatohet se kreditori propozimin për përmbarim e ka ushtruar me datën 25.10.2022, atëherë nuk kemi parashkrim të kërkesave tatimore për periudhën e kërkuar 2017-2022 në shumë prej 2,482.99 euro, andaj, gjykata e shkallës së dytë me aprovim si të bazuar të ankesës dhe vlerësim të shkresave të lëndës, vërtetim ndryshe të gjendjes faktike, gjeti se gjykata e shkallës së parë ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale duke vërtetuar gabimisht gjendjen faktike se dokumenti përmbarimor i ofruar nga kreditori për ekzekutimin e detyrimeve tatimore të pa paguara nga debitori nuk përbën titull përmbarimor, prandaj, mbi bazën e të lartcekurave, gjykata e shkallës së dytë, gjeti se duhet ndryshuar aktvendimi i atakuar me ankesë, duhet refuzuar prapësimi i debitorit dhe duhet të mbetet në fuqi urdhëri për lejimin e përmbarimit i organit përmbarues, për arsyet e lartë cituara.

Prandaj, Gjykata e Apelit, mbi bazën e të lartcekurave, në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 194, 201, pika b), në lidhje me nenin 208 dhe 209, pika c), të LPK-së, gjeti se duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
C.A.P.nr.1808/23, me datë 19.03.2024

Gjyqtari Individual
Besnik Feka